



EDHE KOMUNA IME!

ZËRI IM, TË DREJTAT E MIA, KOMUNA IME!



TETOR 2022



Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve në nivel lokal



A e dini se si qytetarë i Kosovës jeni të barabartë dhe keni të drejtë në shërbime të njëjta nga institucionet publike?

Çfarë do të thotë barazia?

Do të thotë se, pavarësisht përkatësisë etnike, ngjyrës, racës, besimit etj., keni të drejtë të barabartë në qasje në të drejta dhe shërbime të ofruara nga institucionet komunale.

Për më tepër, në çdo komunë me bazë në komunitet janë krijuar edhe Mekanizmat për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve, ku ju mund të adresoni shqetësimet dhe kërkesat tuaja.

Në rast se ju nevojitet ndihmë apo përkrahje për të parashtruar ankesë apo për të ngritur ndonjë shqetësim lidhur me të drejtat tuaja pikë e parë e kontaktit është komuna juaj.

1. Nënkrystari i Komunës për komunitete

Nënkrystari i komunës për komunitete (NKKK) është mekanizëm lokal mbrojtës ku komunitetet përbëjnë të paktën dhjetë për qind të popullsisë së komunës. Por, me vendim të kuvendit të komunës, mund të krijohet edhe në komuna ku popullsia nga radhët e komuniteteve në pakicë numerike nuk e arrijnë prapen prej dhjetë për qind. NKKK ka mandat që të ofrojë këshilla dhe udhëzime për kryetarin e komunës për çështjet që lidhen me komunitetet dhe duhet t'i përfaqësojë të gjitha komunitetet që banojnë në komunë.

Kontakt:

▶ **Pejë: Nënkrystari për komunitete Mirzet Džogović, Rr. Hasan Prishtina pn., Objekti i Komunës e re, kati i tretë;**
+383 (0) 45290612; mirzet.dzogovic@rks-gov.net

2. Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete

Zëvendëskryesuesi i kuvendit komunal për komunitete (ZKKKK) është mekanizëm lokal mbrojtës në komunat ku komunitetet përbëjnë të paktën dhjetë për qind të popullsisë së komunës. Është i mandatuar për t'i shqyrtuar ankesat nga pjesëtarët e komuniteteve në lidhje me shkeljet e të drejtave të tyre përmes akteve ose vendimeve të kuvendit komunal dhe është përgjegjës për referimin e pretendimeve të tilla në kuvendin e komunës.

Gjithashtu, mund të kërkojë rishqyrtimin e aktit ose vendimit përkatës. Në rrethana specifike, ZKKKK mund t'i drejtohet gjithashtu Gjykatës Kushtetuese dhe t'ia paraqesë aktet ose vendimet që konsideron se shkelin të drejtat e garantuara me kushtetutë.

Andaj, nëse konsideroni se një akt ose vendim i komunës përbën shkelje të pjesëtarëve të komuniteteve në komunën tuaj, sigurohuni që të njoftoni ZKKKK-në për të adresuar shqyrtimin para kuvendit komunal.

Kontakt:

▶ **Shtërpçë: Rruga kruesore, Objekti i Komunës;**
+383 (0) 44731485; valmir.ahmeti@rks-gov.net
▶ **Pejë: Rr. Hasan Prishtina pn. Objekti i Komunës e re;**
+383 (0) 49319433; avdulah.djesevic@rks-gov.net
▶ **Leposaviq: Rr. Vojske Jugosllavije pn.; + 383 (0) 2883050**

3. Komiteti për Komunitete

Komiteti i komuniteteve (KK) është një mekanizëm i rëndësishëm për pjesëmarrjen e komuniteteve joshumicë në nivel lokal, për të siguruar respektimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve, përmes shqyrtimit të politikave dhe veprimeve të autoriteteve komunale dhe dhënies së rekomandimeve përkatëse. Anëtarësia përbëhet nga pjesëtarët e të gjitha komuniteteve të pranishme në kuvendin komunal, dhe përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë të përfaqësuar në kuvend.

Mund ta njoftoni komitetin nëse mendoni se jeni diskriminuar në çfarëdo forme për shkak se jeni pjesë e një komuniteti të caktuar.

Kontakt:

▶ **Shtërpçë: Rruga kruesore, Objekti i Komunës;**
+383 (0) 44800330; blerta.hazizi@rks-gov.net
▶ **Pejë: ul. Hasan Prishtina bb, zgrada nove Općine;**
+383 (0) 45937189; fatlinda.radi@rks-gov.net
▶ **Leposaviq: ul. Vojske Jugosllavije bb.;**
+ 383 (0) 2883050

4. Zyrtat Komunale për Komunitete dhe Kthim

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) është përgjegjëse për rritjen e mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve dhe për të siguruar qasje të barabartë të komuniteteve në shërbimet publike në nivel komunal.

Zyrtat për komunitete janë në gjendje që të ofrojnë këshilla mbi disponueshmërinë e shërbimeve publike dhe për çdo shqetësim që mund ta keni në lidhje me politikat komunale si pjesëtar i një komuniteti joshumicë.

Kontakt:

▶ **Shtërpçë: Pranë Objektit i Komunës, Zyra nr.2.**
+383 (0) 44446761; +383 (0) 3820046917;
tihomir.durlevic@rks-gov.net
▶ **Rr. Hasan Prishtina pn., Objekti i Komunës e re, Zyra nr.1.**
+383 (0) 45724000; sabahudin.cirikovic@rks-gov.net
▶ **Leposaviq: Rr. Vojske Jugosllavije pn.; Objekti i Komunës;**
ismet.islalovic@rks-gov.net

5. Njësitë komunale për të drejta të njeriut

Njësitë komunale për të drejta të njeriut janë përgjegjëse për ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, këto njësi kanë për obligim të trajtojnë ankesat individuale për të drejta të njeriut dhe duhet vazhdimisht t'ju informojnë për statusin e ankesës që e keni parashtruar në komunë.

Zyrtat e njësive komunale për të drejta të njeriut gjenden në objektin e komunës tuaj:

▶ **Shtërpçë: Rruga kruesore, Objekti i Komunës, zyra nr.34.**
+383 (0) 49921529; radica.milosavljevic@rks-gov.net
▶ **Pejë: Rr. Hasan Prishtina pn., Objekti i Komunës e re, kati parë**
+383 (0) 49497404; teuta.blaka@rks-gov.net
▶ **Leposaviq: Rr. Vojske Jugosllavije pn.; + 383 (0) 2883050**

6. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (KKS), janë forume të sigurisë të cilat janë të themeluara në çdo komunë të Kosovës me vizion për përmirësimin e sigurisë dhe stabilitetit në komunitet. Këshilli komunal kryesohet nga kryetari i komunës.

Nëse keni ndonjë shqetësim apo ankesë në lidhje me ndonjë çështje të sigurisë, si për shembull mungesë të shtyllave ndriçuese në lagjen tuaj, apo nëse keni nevojë për më shumë polici në komunitet, mund t'i ngritni në takimet e këshillit komunal për siguri në bashkësi. Gjithashtu, mund t'i diskutoni shqetësimet tuaja me cilindo anëtar të këshillit dhe mund të kërkonti nga ai/a jo që t'i ngritë çështjet e tilla në takimin e ardhshëm të këshillit.

Kontakt:

▶ **Shtërpçë: Kryetari i Komunës z. Dalibor Jevtić,**
Rruga kruesore, Objekti i Komunës, kati i dytë,
+383 (0) 38 46 901; dalibor.jevtic@rks-gov.net
▶ **Pejë: Kryetari i Komunës z. Gazmend Muhaxheri, Rr. Hasan Prishtina pn., Objekti i Komunës e re,**
+383 (0) 44237238; +383 (0) 45126000;
gazmend.muhaxheri@rks-gov.net; fatmir.asllani@rks-gov.net
▶ **Leposaviq: Kryetari i Komunës z. Zoran Todiq,**
Rr. Vojske Jugosllavije pn.; +383 (0) 2883860;
ouleposavic@gmail.com